

Sektorin e veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 68 të Rregullores gjyqësore ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 66/2013 dhe 114/2014), si dhe nenet 31, 34, 37 dhe 41 të Rregullores së punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 13/98 dhe 21/09), në seancën e mbajtur më 07.12.2021, miratoi këtë:

## MENDIM JURIDIK

**Sipas nenit 336 paragrafi 3 të LPP këshilli për vlerësim të aktakuzës gjatë vlerësimit të aktakuzës vlerëson nëse natyra, arsyet e akuzës dhe provat e parashtruara në shtojcë të aktakuzës janë të pranueshme ta konfirmojnë dyshimin e bazuar për të akuzuarin.**

**Këshilli për vlerësim të aktakuzës nuk i analizon provat, as nuk e vlerëson cilësinë e provave vetëm ka kujdes nëse ndonjë provë është siguruar në mënyrë joligjore në suaza të ankesës.**

**Kualifikimi juridik i veprës penale gjatë formës themelore të veprës është objekt i diskutimit dhe të vlerësimit të këshillit gjykues.**

## A r s y e t i m

Në Sektorin e veprave penale, të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes Sektorit të praktikës gjyqësore të kësaj gjykate është dorëzuar Iniciativë mbi mendim juridik parimor nga Kryetari i Sektorit penal të Gjykatës Themelore Strumicë mbi këto çështje juridike:

1. Nëse dispozita e nenit 336 paragrafi 3 të LPP, e lejon Këshillin për vlerësim të aktakuzës gjatë vlerësimit të aktakuzës lidhur me "shkresat e lëndës dhe provat në shtojcë të aktakuzës", ti lexojë provat e prokurorisë dhe nëse sipas atyre provave del se ekziston ndonjë nga bazat për refuzimin e aktakuzës, të miratojë vendim në pajtueshmëri me nenin 337 të LPP dhe

2. Nëse dispozita e nenit 338 paragrafi 2 të LPP e lejon Këshillin për vlerësim të aktakuzës ta ndryshojë kualifikimin juridik të veprës, për të cilën ngarkohet i akuzuari. Nëse Këshilli mund ta **aprovtojë edhe akuzën me kualifikim tjetër juridik, vallë bëhet shkelja e parimit dyshkallësh, duke qenë se në Aktvendimin për aprovim, palët nuk kanë të drejtë ankese.**

Duke vepruar mbi iniciativën e parashtruar Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, konstaton se vlerësimi i aktakuzës është rregulluar në nenin 336 të Ligjit për procedurë penale, ku sipas paragrafit 3 të nenit të theksuar të Ligjit, Këshilli për vlerësim të aktakuzës e vlerëson aktakuzën nga aspekti i të dhënave në

ankesë kundër aktakuzës, shkresat e lëndës dhe provat e parashtruara në shtojcë të aktakuzës.

Ankesa është rasti që Këshilli ta shqyrtojë aktakuzën nga ana formale dhe materiale.

Gjatë vlerësimit të aktakuzës Këshilli vlerëson nëse natyra, arsyet e akuzës dhe provat e parashtruara në shtojcë janë të pranueshme të aprovojnë dyshimin e bazuar të akuzuarit.

Këshilli për vlerësim të aktakuzës, nuk i analizon provat dhe as nuk e vlerëson cilësinë e provave, nuk lëshohet në besueshmërinë e rrëfimeve dhe mbrojtjen e të akuzuarit, në vlerësimin e provave kontradiktore por as në fuqitë dëshmuese të provave të mbledhura, vetëm ka vëmendje nëse ndonjë provë është siguruar në mënyrë jologjore në suaza të ankesës. Vlerësimi i këtillë duhet ti lëshohet këshillit gjykues të diskutimit, në procedurë kontradiktore, duke respektuar principin e barazisë së mjeteve.

Te çështja e provave të mjaftuara nuk vlerësohet përgjegjësia penale, por dyshimi i bazuar që do ta arsyetonte prezantimin e gjendjes në gjykatë.

Duke marrë parasysh jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut “dyshimin e bazuar” se ka qenë e kryer veprë penale nënkupton ekzistim të fakteve ose informacioneve me të cilat mbikëqyrësi objektiv do të mund të bindet se personi i prekur ndoshta e ka kryer veprën penale (*Erdagoz kundër Turqisë (Erdagoz v. Turkey)*, 22 tetor viti 1997, § 51, Reports of Judgments and Decisions 1997-VI; *Fox, Kampbel dhe Hartli kundër Mbretërisë së Bashkuar (Fox, Campell and Hartly v. the United Kingdom)*, 30 gusht viti 1990, § 32, Series A nr.182).

Çka mund të konsiderohet si e “bazuar”, megjithatë, varet nga të gjitha rrethanat e rastit (*Fox, Kampbel dhe Hartli kundër Mbretërisë së Bashkuar (Fox, Campell and Hartly v. the United Kingdom)*, 30 gusht viti 1990, § 32, Series A nr.182).

Dyshimi duhet të mbështetet me fakte konkrete. Këshilli i cili vendos mbi ankesën nuk është i autorizuar që të vlerësojë nëse faktet dhe rrethanat me të cilat akuza themelohet ofrojnë provë të sigurt, sepse i akuzuari ka kryer veprë penale, por edhe nëse janë plotësuar kushtet për tu shpallur fajtor, ngase ajo për aktakuzën nuk është e nevojshme.

Nga këtu, për të qëndruar aktakuza mjafton nga provat e parashtruara që të mund të konkludohet se ekziston dyshim i bazuar se ka kryer veprë penale, që i ngarkohet. Ankesa nuk është mjet juridik kundër vendimit gjyqësor, por mjet juridik për kontrollimin e ekzistimit të mjaft bazave për nxjerrjen e të akuzuarit në gjykatë.

Këshilli që vendos mbi ankesën nuk lëshohet në analizën e provave, as në vlerësimin e provave kontradiktore. Në diskutimin gojor, drejtpërdrejtë dhe në procedurë kontradiktore ajo realizohet në këshillin gjykues, kur zbatohet standardi i dëshmimit përmes shqyrtimit të materialit të tërësishëm dëshmues dhe vlerësohet rëndësia e saj.

Nga këtu, Këshilli që vendos për ankesat vlerëson vetëm nëse ka prova dhe nëse ato prova janë të pranueshme ta konfirmojnë konkluzionin se ekziston dyshim i bazuar se i akuzuari ka kryer veprë penale.

Këshilli që vendos për ankesa nëse konstaton se nuk plotësohen kushtet për refuzimin e aktakuzës si të pabazë në kuptim të nenit 337 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për procedurë penale, do të lëshohet në çështjen e kualifikimit juridik të veprës penale të dhënë në akuzë vetëm atëherë sa është e nevojshme për tu konstatuar kompetenca reale, ose rregullsia e procedurës (mbrojtja e detyrueshme, paraburgimi dhe të ngjashme). Kualifikimi që është dhënë nga Prokuroria publike nuk është i detyrueshëm dhe as përshkrimi i gjendjes faktike që e ka dhënë prokuroria, nëse ai përshkrim nuk pajtohet me gjendjen e shkresave, dhe jo me vlerësimin se nuk ka vend për akuzë, nuk do të ndërpritet as procedura nëse kualifikimi juridik është i parregullt, ndërsa vepra penale ekziston.

Kualifikimi juridik i veprës penale gjatë ekzistimit të formës themelore të veprës është objekt i diskutimit dhe vlerësimit të këshillit gjyqësor.

Ndryshimi i kualifikimit juridik të Këshillit për vlerësimin e aktakuzës është i papajtueshëm *ratione materiae* me dispozitat e Ligjit për procedurë penale.

Në bazë të së theksuarës, për miratim të një Mendimi të këtillë juridik, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut konstaton se, me rëndësi të posaçme është në situata kur kushtet në ligjet janë mjaft precize të shënuara, por gjatë interpretimit të së njëjtëve të pamundësohet arbitrariteti, divergjenca dhe mospërshtatja me zbatimin e qasjes më të unifikuar dhe më sistemuese gjatë procedimit.

## **Spektori i veprave penale**